



Përmbledhje poezish nga
nxënësit e shkollës
"Asdreni"

Pejë, 2019

Përmbledhje poezish nga
nxënësit e shkollës
Asdreni

Pejë, 23 prill 2019

PARATHËNIE

Lexues të nderuar! Këtu keni mundësi të lexoni një përmbledhje të vjershave të shkuara të nxënësve të shkollës SHMU “Asdreni” në Pejë.

Duke parë vlerat e shkrimeve të poetëve të rinj të kësaj shkolle ,talentin e tyre gjatë orëve mësimore dhe jashtë saj , ne mësuesit e kësaj shkolle së bashku me përkrahjen e drejtoreshes së shkollës: Agime Lajçi vendosëm të botojmë këtë përmbledhje poezish.

Nxënësit e kësaj shkolle në vjershat e tyre kanë shkruar poezi: për dëshmorët e lirisë, ushtarët, Kosovën e lirë, Shqipërinë si vend i shqiponjave të lira, mërgimin, mallin për ata që s’janë, nënën, mësuesit e tyre, jetën, gjuhën shqipe dhe fuqinë e saj, varfërinë, Bajram Currin, Asdrenin, për ditët e festave të flamurit, si e duan vendin , dallëdyshet, klasën , stinët e vitit, muzikën, lumbar dhin e çdo gjë e bukur që I rrethon. Shpresojmë se do të jeni të kënaqur gjatë leximit të këtyre shkrimeve.

Nga kjo shkollë nxënësit që shkruajnë vazhdimisht poezi ka mjaftë ,por ne zgjodhëm disa prej më të talentuarve si:

Gjon Culaj - IX, Flandër Kuqi - VIII, Erta Muçkurtaj - VIII
Blerta Gjickolli - VIII, Vesa Selmanaj - VII, Teuta Markaj - VII
Riad Gashi - VI, Eljesa Hasanaj - VI, dhe Tefik Agusholli - VI

Nxënësit që shkruan dhe vazhdojnë të shkruajnë edhe në të ardhmen do të na pasurojnë jetën me frymëzime poetike.

USHTARI


Luftuat për nënë e motër
Luftuat për këtë voter.
Rrugë e gjatë, rrugë pa krye
Ushtari në shtëpi nuk u kthye.

Kaluan ditë, muaj, po thujse një vit
Nëna pranë oxhakut të birin mbet tu e prit.

U kthyen disa ushtarë
Por pa këmb e pa duar
Nënat e larguan pritjen e duruar.

Pritën me ditë të tëra por ushtari nuk mbërriti,
Ndoshta për Kosovën dhe fundin e arriti.

Lufta qe e pa mëshirë
Ra ushtari zemërmirë
Por dhe i rënë armiqtë po i frikëson
Sepse në zemrat tona ai ende po jeton.



Elsa Çavderbasha

SHQIPËRI-O NËNA IME

Ti Shqipëri, o moj nënë,
Pse ty ngusht të paskan zënë?
Pse të keqen po ta ndjellin?
Pse vetëm vuajtje po të sjellin?
Asnjë ditë nuk është si sot
T'bëra nënë, t'bëra baba, t'bëra zot.
Tokën tënde do e laj me lot.
Askush dot nuk do t'na ndaj,
Sikur lisi me gjethe rranj.
Sikur gjethi që bie në tokë
Sikur trimi me plot shokë.
Të drejtohem ty ,o zot
Ti bekosh këto male për mua
Moj Shqipëri, o nëna ime
Ti e di sa fortë të dua.
Të dua si dielli hënë e hëna diellin
Si lumi shtratin e reja qiellin
Po të lutem, trimat tanë le të na i sjellin.

SHQIPËTARËT

O shqipëtarë ngado që jeni
Pos Shqipërisë tjetër vendlindje s'keni?
O shqipëtarë, a ju rrah kjo zemër,
N'gjithë këtë jetë ke veç një emër.

E ke emrin shqipëtar
Mos të të thërrasin mërgimtar.
Kënduam me lahutë, sharki, e qifteli
Jeta në mërgim, jetë si në qeli

Na rriti pushka edhe plisi
U shpërndamë si degët e këtij lisi.
Por si shkëmbi që rëndon
Shqipërinë nuk e harron.
Kjo gjë neve na bashkon
Kjo gjë neve na gëzon.

SHQIPONJA E ARRATISUR

Një derë po hapet
Një degë po kërcet,
Shqiponja e arratisur
për ndihmë po thërret.

Një njeri po gropon
Po gropa po mbulohet,
Një njëri po shpreson
Po shpresa po largohet.

Një liqen po kalon
Po pastaj shterohet,
Dikush po lufton po
Pastaj harrohet.

SHQIPËRI ETNIKE

Shqipëri etnike, ku mbete ti?
U ndave u coptove
Pjesët e tua me vete- pse si more?

Luftove trimërove
Ti kurrë su dorëzove
Se ti këtë e meritove
Prandaj u pavarësove.

Luftuam me shpatë
Luftuam për nënë e atë
Luftuat për liri
Se u lodhem nga kjo robëri.

PËRSE...

Përse me luftë duhet zgjidhur?
Përse gjak duhet derdhur?
Përse ne vallë na kanë zgjedhur?
Mos vallë bëmë ndonjë gabim?

A nuk ju dhimbset ky njerëzim?
Pse e kërkoni vendin tim?
Pse e marrët këtë vendim?
A do marr ndonjëherë përgjigje?

A po vetëm kur të shkoj në tjera brigje?
Mua kush do më ndihmoj?
Se edhe unë ndihmë po kërkoj?
Jo vetëm për vete,
Por për të gjithë njësoj!!!

PËR JU O DËSHMOR...

Sa dhimbje kemi
Edhe pse të lirë jemi
Për ju o dëshmor
Sot e mbajmë flamurin në dorë.

Na kujtohen ditët kur ikët
Për ju o dëshmor
Që vdekja ju priti në Vlorë.
Do ju kujtojmë

E do ju lavdërojmë
Për ju o dëshmor
Që zemra më ka qarë
Ju ngritet flamurin tonë
Flamurin ndërkombëtar.

NJË DITË HYJNORE

Një ditë hyjnore
Një ditë e shenjtuar
Nëna Shqipëri ,o nënë e bekuar.
Djemët e tu
Simboli trimërisë
Urime të gjithëve
Ditën e lirisë.
Urime Shqipëri
Urime diasporë
Mos harroni ditën
Kur u ngrit flamuri në Vlorë.
Ishte viti 1912
Kur flamuri jonë u ngrit
U ngrit e i lirë valoj
Këtë ditë kurrë se harroj!



Vesa Selmanaj

NE NA BASHKON

Është ky plis
Ky flamur, kjo gjuhë e
ky komb që na bashkon
Shqiponja arratisur
për ndihmë po kërkon.

Është kjo tokë
E madje edhe malet
Dashuria jote s'mund të blihet
Por vetëm të falet

S'mund të blihet as me para,
as me ar, e gjevahire
Në histori do mbetesh,
si Shqipëri martire.
Tash do thon haj- medet

Se trimi dha jeten per token e vet
E shqiponja përkrenare
Po shikon , e po mendon
Qerdhen në vendlindje ta ndërton!!

MOJ SHQIPËRI

Pse kokën ule ,moj Shqipëri?
Kur ti ke plot djem të ri.
Qysh po vrahët vllau me vëlla?
Qysh Shqipëria, o tu nda?
Pse ky dhe qenka tha?
Pse ma burrat nuk janë pa?
Qenka ndal zjarri në votër
Ti mur i huaj, nanë e motër.
Shqipëria paska mbet si gruaja pa burrë.
Sikur nëna që djalin se pau kurrë
Shpesh po pyes: Shqipëri si je?
Sikur lisi i shtrirë ndër dhe
Shpesh po pyes si po kalon?
Sikur plaku që qalon.
Sikur reja që në qiell krijohet
Pse Shqipëria po coptohet?
Dikur ti ke qenë ma e mira
Tokat e tua , toka të dlira.
Vajzat e tua të bardhë atë fytyrë
Zemrën e pastër si pasqyrë.
burrat e tu simbol I trimërisë

ata mbrojtën tokat e Shqipërisë.
Por pse mes veti ata po shahen?
kështu shqiptarët po përqahen.
E pse qielli po gjëmon?
Pse shqiponja e lirë s'qëndron?
Pse flamuri s 'po valon?
Moj Shqipëri ,e mjera ti
Shumë luftove për këtë liri.
Moj Shqipëri ,moj e mjerë
Edhe zani tu paska shtjerr.
Tu ka shtjerr e s' po tingëllon ma
Një zot e di se çka u ba
Tash sa vjet sundon robëria
Gjer sa erdhi pavarësia.
Gjersa dera kafazit e hapur qëndroj
E shqiponja e lirë fluturoj.
Udhën kush në gjysmë ta ndali
Gjithë dashurinë nga zemra ta fali.
Fati yt, fat I kryqëzuar
Historia jote , histori e pambaruar.
E ta dish për çfarë po zihen shqiptarët
Se s'qëndrojnë kryelartë

E flasin për kisha e gjamia
Por feja juaj është veç Shqiptaria.
Moj Shqipëri, moj e mjerë
Tantuan ta merrnin këtë nder.
Por po ju thërras -o shqiptar,
Për çfarë jeni ju krenarë ?
S'marr përgjigje ,përgjigjem vet
E s'qëndroj si i shkretë.
Jemi krenarë që nuk u frikësua
Jemi krenarë që nuk u dorëzuam
Jemi krenarë e kështu do qëndrojmë,
Për vendin tonë gjithmon do luftojmë.
Se Shqipërinë zoti për ne e fali
Trimat tanë askush si ndali.
E sa moti të kaloj
Djal e nip këtu do qëndroj.
Disa për ty luftuan
Por dhe disa të tjerë të tradhtuan , tjerë e të tjerë
Të lanë ty të mjerë.
Eh sa shpejt koha vajti
Su harru syri që për ty qajti.
Su harru heroi që luftoj

E as nëna që të birin e vajtoj
E as djali që mbeti pa baba
Që e lirë t' fluturoj shkaba.
Por prapë se prap ti do ta marrësh
O Shqipëri atë emër
Që mua më ka mbetur në zemër.
E dyert më nuk do I mbyllin
Se për ty ata do pyesin
Shqipëria qenka liruar
E dëshmorët s'janë harruar
E thërret Presheva me lot në sy,
Ku je motër Qamëri
Padrejtësisht I kanë ndarë
Madje dhe trimat ja kanë vrarë
Rruga ishte shumë e gjatë.
Por ja vlejti guximi që ja nisen
Vallë flamurin a e qëndisen.
Babait I vdiq djali
Por jo krenaria
Se krenari ishte vet trimria
Nënës I vdiq fëmija
Por të paktën ai se braktisi
Se zemra ju thye siç thehet dega e një lisi
Shqipëria u rrëzua ,por prap në këmbë u ngritë
E shqiponja qëndroi në flamur duke prit.
Le të shpresojmë , të shpresojmë që s'ka me zbrit.

MËRGIMTARË!

U largova përnjë jetë më mirë
Por ja që ishte më vështirë.
U largova për të punuar
Por këtu puna më ka dërrmuar.
Pse mora rrugën, e u nisa
E pse vendlindjen time e braktisa.
Pse pranova në gurbet të shkoj
E vendlindjen ta harroj.
Dikur mua më thërrisnin shqipëtar
Tash më thërrasin mërgimtar.
Emër i shëmtuar
S'kam për ta harruar
Po vall unë si u mashtrova
E larg në mërgim unë shkova?
Po vallë unë si pranova
E në atdhe nuk qëndrova.
Ndoshta trupin e kam mirë
Por mua shpirti po më dhemb
Sikur në këmbë kur të hyn një gjemb.
Ndoshta jam shuar si qiri
Që nuk luftova për liri.
Ndoshta zjarri brenda meje është fikur
Që nga vendlindja ime kam ikur.
Pse vallë zemra mua mu thye,
Ngaqë në vendlindje nuk u kthye.
Pse duart po më dridhen
Shumë gjëra në mendje më zihen!

MALLI PËR TY

Dikur të shihja me sytë e mi
E tashti vetëm në fotografi.
Dikur malli për ty nuk më merrte
E tash nuk mund ta shuaj
Një zot e di për ty sa po vuaj.
Tri vite kanë kaluar
Por s'të kam harruar
Cdo ditë që kalon
Më shumë më lëndon.
Zemra vet flet
Dora vetëm i shkruan
Por ndjenjat nuk i shuan.
Jeta është e gjatë por prap ka një mbarim
Por malli për ty s'ka përfundim.
Malli për ty si n'zjarr kur hedh benzin
E unë si një lule e vetme në lëndinë
Si një yll në univers
Ditën kur do të takohemi, gjithmonë do e pres!



Elsa Çavderbasha

LOTI I NËNËS

Djali I nënës në dhe ju ka mbulu
E ma kurrë nuk ka me u shplu
Sytë e nanës ty lotu
Lot pas loti ty i piku.
Njerëzit nanën tu e ngushëllu.
Por kot janë duke u mundu
Se mërzia s'ka me i kalu.
Nana e ndjenë vetën n'faj
Me zë t'lart fillon të qajë.
Një zbrazëti ajo e la
Për të birin që se ka.
Ditët bëhen netë
E netët ditë prap kanë me qenë
Nana pa fëmijën e saj ,nuk thirret nënë
Lotët e saj s'kanë me u ndal
Se askush t'birin s'ka me ja fal.
Shpirti do ti bëhet shkrum e hi
Se nënat bëjnë çdo gjë për fëmijë.

LIBRI

Kush librin e lexon
Flori po kërkon
Libri të jep plot dituri
Miku më I mirë në përjetësi.

Kalon një ,faqe e kurrë se kupton
Sikur pa një, ditë kur jeton
Libri shumë të meson.

Libra shumë të lexoni
Ëndërrat tuaja mos I lëshoni
Sepse nga ta ju mësoni
Kurrë të paditur s'do qëndroni.
Lexon një kapitull
Të hapet një derë
Lexo poezi se ato kanë shumë vlerë.
S'janë shkruar kot
Ai është një shok
Shok i kërkuar. libër I uruar.



Adna Sadiku

KOSOVA IME E DASHUR

E prangosur ishe por tani me nuk je
E roberuar ishe por tash liri ke
Në kafaz ishe por kafazi hapur po qendron
Kosova ime dashur plaget po I sheron
Plaga do të shërohet

Por shenja do të mbetet
Emri I ushtarit kur nuk do te tretet
Buqetat me lule
Ne varre do ti dergojme
Deshmorët që rane kur s'do ti harrojmë

Kjo ishte ëndrra juaj por tash është realizuar
Urime Kosovë
këte 17 shurtin e bekuar
Famuri me 6 yje I lire do valoj Kosoven time
Te dashur gjithmone do e kujtoj!

JU LUTEM...

Dua që të jetoj
Që jetën ta gëzoj
Nuk dua që të vdes
Dua që në histori të mbes, sytë mos mi verboni.
Dua t'ju shoh lumenj të buroni
Këmbët mos mi thyeni
Se dua që të vrapoj
Vendin tim të bukur
Dua ta shijoj.
Duart shëndosh e mirë mi lini
Se dua të punoj
Për vendin tim të dashur
Do të kontriboj, ju lutem më vrisni.
S'dua të jetoj vendin tim diçka e keqe e mallkoi
Ju lutem më verboni ,s'dua të shikoj
Çfarë I ndodhi vendlindjes sime
S'mund ta imagjinoj
Ju lutem këmbët mi këpusni
Se të ec s'dua të vazhdoj
Në vend të huaj s'dua që të shkoj.

“JETA”

Kjo jetë e shkretë
Si zjarr po djeg
Djeg e shkrumbon
Vetëm vuajtje shkakton.

Si era kur fryente
Lisa e pemë, mua shpirti po më dhemb.
Rruga e gjatë
E mbuluar me errësirë
Jeta qenka e pa mëshirë.

Dikur bilbilat këndonin
E tash as zë nuk lëshojnë
A është jeta kështu,
apo njerezit po gabojnë?!

I PANJOHURI

Aty s'mbeti më asnjë njeri
Në tokë bën dritë e u ndez një qiri.
Toka me lule u mbulua
I panjohuri nën dhe u shua.

Varri i tij në vetmi qëndron.
Ndërsa nëna akoma po e kërkon.
Guri në varr dalngadalë coptohet
I panjohuri po harrohet

Ndonëse kishte dhe fëmijë
Por luftoi për liri edhe jetën e tij e dha.
Gjurmët e tij në histori i la
I pa njohuri dëshmor ra

Varri i tij nga asnjë su pa
Se i panjohur lindi
E i panjohur u rrit,
Të panjohurit përmendore ju ngrit.

GJUHA SHQIPE

E lashtë kjo gjuhë
I lashtë ky emër
Duaje gjuhën me gjithë zemër.

Si rrëkeja rrufes shtegtare
Si kjo ditë legjendare
Ashtu është gjuha jonë kombëtare.

Me lot është larë
E me gjak e krijuar
Mbarë trojet shqiptare
Kjo gjuhë ka bashkuar.

GJUHA JONË

Por si rrjedha e Drinit të bardhë
Gjuha shqipe po rrymon

Por si zani I bilbilit
Gjuha shqipe tingëllon.

Por si era që lehtë fryen
Gjuha shqipe na gëzon,

Por si zogu që fluturon
Gjuha shqipe e lirë qëndron

Janë dy vllazër kokë me kokë
Një i bardhë e një I zi

Gjuha shqipe do të ruhet
Si këtu dhe në malësi.

EMRI SHQIPËTAR

O shqipëtar nga do që jeni
Ndaluni një çast e mendoni
Nënë tuaj falënderoni
Se ju lindi në Shqipëri

E emrin ja u la shqipëtar
Që dhuron dashuri,plot dashuri e zjarr.
Eshtë ky emër shqipëtar
Që mua zoti ma ka fal

I vogël e mora e s'do ta lëshoj
Edhe kur të vdes shqipëtar do të qëndroj.
Nëna ma la,Shqipëria ma dha
E unë do e mbaj

E nga gëzimi do qaj.
Herojntë tanë për këtë luftuan
E ne besnik do i qëndrojmë
Emrin shqipëtar kurrë s'do e harrojmë.

DITA LEGJENDARE

Ajo shpatë që vrau armikun
Ai njeri që sot mungon
Ai u prehtë në paqe për atdheun tone.

Kaloi robëria
Kaloi mizoria
Tash triumfon trimëria ,se na frymëzon liria.

O 28 nëntor
O ditë legjendare
Ti simbolizon vuajtjen e tokës shqiptare.

Moj shqiponja në flamur
Ti sot stolise këtë mur.
Jam krenar e do vazhdoj të krenohem
Se jam shqiptar e nuk do të dorëzohem.

DËSHMORËT VDESIN, FËMIJËT JETIMA MBESIN

Çfarë ka ndodh me trimat tanë
Po na thojnë që na kanë vra,
na kanë vra e na kanë sha
Se s'po pyesim çka me ba.
Qohet i pari e po flet
Trima tjerë ai po I thërret
Kush po vjen ai po pret.
Qohet nana tu e vajtu
Djalin e vet tu e kërku.
Nusja ma nuk I ndejti
Djali ndjep asaj I fjeti.
Flet kryeplaku me za të lart
Nja dy ,tri fjalë mirë po I cungon
Por pak kush po I kupton.
Këto fjalë si motivim.
Pyet nana:Ku po shkon- o biri im?
Djali nanës po i thot:Në atë luftë pa mbarim
Do luftoj për vendin tim.
Do luftoj për liri
Ne shtëpi do kthehem kryelart ,me krenari!

DASHURIA

Si udhëtar në jetën time
Qe kjo dashuria ime.
Ishte plumbi që zemrën ma përshkroj
E po të njëjtën zemër ma coptoi.

E ylberi si një lamtumirë
Buzëqeshja e saj ,oh sa e dliirë
Përçafimi saj sa i ngrohtë
Më kujtohet edhe sot.

Dora jote kur më preki
Mua n'zemër ajo ditë më mbeti.
Do kaloj dekada e dekada
E prap ty do të dashuroj
Ato që me ty i kalova
Më s'do i përjetoj.



Gerta Ahma

BEJTEXHINJTË

Jemi nisur për gurbet
Neve rruga na ka tretë
Një selam të na dërgoni
Mirë që jeni të na tregoni.
Në shkolla turke po mësojmë
Shqip të flasim nuk guxojmë
Po na shtyjnë drejt një tmerri
Po na shtyjnë drejt një ferri.
Tash emrin bejtejxhinjë na e lanë
Shqipet hallin po na e kanë
Nana me lot ty gjëmu
E të birin tu e kërku.
Malli tash po e mbytë
E me lot ju mbushën sytë
Ku më vajti mua jeta
Çfarë po bën nëna e shkreta.
Gjumi natën s'po e merr
Se edhe dita ju bo terr.
E zemra ati ju coptua
Malli për atdhe kurrë su zvogëlua.
siç po rritet dëshira për liri.
Nuk po shuhet malli për shtëpi
Si po thot Nezmi Berati
Gjuha shqipe do rjedh si mjalti.

BAJRAM CURRI

Jepet besa, burri-burrit
Ndihet zëri i Bajram Currit
Shqipet tash po e thirrin babë
E nga larg na ruanë si shkabë.

Tek Shpella e Dragobisë
Vdiq heroi i malësisë
Bajram Curri luftëtar
Zemër ngrohtë, zemër bujar.

Bajram Curri n'Shpell të Dragobisë
Tregoj lakmin e serbisë
E malazezët shkun gjë pa marrë.

Si gomari pa samar.
Bajram Curri I Kosovës
Ruajti malet e Gjakovës.

ASDRENI

Disa pushkën se lëshuan
Disa morën penën edhe shkruan
Disa fjalët e zemrës vendlindjes ja kushtuan
E disa gjakun e dhuruan.

Asdreni -dritë ne erësirë
Ndaj armikut i pa mëshirë
Asdreni një lule borë
I dha Shqipërisë këtë kurorë.

A PO -A JO

Të pyeta: A do vish?
por përgjigjen nuk ma ktheve
të them të drejtën zemrën ma theve.

Të thash” A po A jo “
por ti nuk më dëgjove
kështu tI prapë më lëndove.

Të pyeta a më do
E ti u ndale e mendove
që më doje kurrë nuk e pranove.

28 NËNTORI

Sa mirë që erdhe o hero kombëtar
O Ismajl Qemajli I hypur në kalë.

Ti dhe burrat e tu për rrugë jeni nisur
Ta merrni flamurin e qendisur.

Ty o Marigonë ,të lumtë ajo dorë
Se ti qendise flamurin që u ngrit në Vlorë.



KUQ E ZI

Si një lule në fushë
Si një pikë në oqean
 Është flamuri kuq e zi
Që valon në liri.

Dy ngjyra kombëtare
Dy ngjyra tradicionale
Jan ato të dyja
Që kujtojnë shumë fytyra.

Ngjyrat kuq e zi
Krijojnë një harmoni
E kjo harmoni
Është gjaku për liri.

I VARFËRI DHE I PASURI

Një grup të varfërish në rrugicë
Po I thërrisnin pakicë.
Një i pasur po kalon
Çdo njeri po e nderon.
Fëmija i pasur fle n'divan shtrirë.
E i varfëri trajtohet pa mëshirë.
Fëmija i pasur shumë jeton krenar
Fëmija i varfër bukë s'ka të marr
Kur mblidhen të pasurit i quajnë biznesmenë
E të varfërit bandit.
Fëmija I pasur n'shkollë shkon me veturë
E fëmija I varfër n'shpin s'ka çantë
Mendime tjera të pasurit kanë për jetë
Ata mendojnë vetëm për kuletë
E i varfëri tjetër gjë mendon
Që i pasuri se kupton
Një i verbër me dorë shtrirë
I thot t'pasurit më ndihmo, o njeri i mirë
I pasuri I thot:" ik i verbër ,more ndyrësirë
I varfëri përgjigjet duke thënë: I verbër
këtu je vetëm ti që paraja të verbon,
me kaq plaku ngjarjen e përfundon.

ËNDRRA IME

Kur isha e vogël
Hyja në mendime
Të bëhem mësuese
Ishte ëndrra ime.

Fëmijët e vegjël
Unë t`i mësoj
Me nota të ndryshme
Ata t`i vlerësoj.

Sot e asaj dite
E kam këtë dëshirë
Të ndjek ëndrrën
Profesionin më të mirë.

Flandër Kuqi Kl.VIII/1

LIBRI , BURIM I DITURISË

Kur e kam në duar
Filloj të mendoj
Kam një gur të çmuar
Që nga ai mësoj.

Shumë e urrejnë
S`duan ta shohin me sy
Por e gjithë e ardhmja jonë
Varet nga ai.

Sa herë e lexoj
Hy në një botë tjetër
Gjëra interesante ka aty
Nuk është vetëm një letër.

Nëpër atë botë
Unë çdo ditë shëtis
Në të vetmin librin
Burimin e diturisë.

Flandër Kuqi Kl.

VIII

PRANVERA

Zogjtë cicërojnë
Bariu i bie fyellit
Qengjat po lodrojnë
Aty afër pyllit.

Në livadhet e blerta
Delet kullosin e blegërojnë
Ujku rri vërdallë
Por qentë s`e lejojnë.

Bletëve punëtore
Po ju qesh fytyra
Se pranvera ju solli
Lule me shumë ngjyra.

Flandër Kuqi Kl.VIII



Vesa Selmanaj

E DUA KËTË DITË HYJNORE 28-NËNTORIN

Ty flamur të qofshim falë,
Rrugës tënde pa u ndalë,
Dritë i dhe tërë Shqipërisë,
Nder i kombit i lirisë.

Nëntorë i kuq me flakë e zjarrë
Me shumë vite me shumë mallë,
Ty të pritëm pambarim,
Luftërat s'shuan mallin tim.

Ditë hyjnore e Shqipërisë,
Je krenaria e ilirisë,
Ty të paqim tash e mot,
Madhështia jote mos shkoftë kot.

Blerta Gjokolli VIII-4

ATËHERË

Asgjë nuk do të kishim, Pa luftëtarët e lirisë,
Toka s'do të ujitej, Pa lulet e rinisë.

Pa lulet e rinisë.
Dashuria s'do të ndjehej

Pa veprat e tyre Jeta s'do të ishte jetë
Pa emrat e tyre.

Këtu e 100 vjet
Do ta ruaj flamurin për ty atdhe

Nga ty mësova
Të flisja gjuhën e nënës sime.

Dhe 100 vjet të tjera
Po të kalonin me ty,

S'do ta shuan mallin,
Që më vlon për ty

Frymo atdheu im ,
I lirë, I gëzuar

Fal jetë nga jeta jote,
jep ëndërr nga ëndërrat tua ,

Në kërkim të lirisë
kurrë nuk u dorëzuam.

Blerta Gjokolli VIII/4

28 NËNTORI

28 Nëntori , kjo ditë hyjnore
Është ndër festat shekullore
Të gjithë e presim me padurim
O sa i gëzuar është vendi im

Në çdo cep e në çdo shtëpi
Valojnë flamujt kuq e zi
Të gjithë shqiptarët brohorasin
Rroftë Shqipëria po thërrasin

Shumë urime kjo festë e bukur
E festofshi të gjithë të lumtur
Ashtu si e kremtuat sot
Shpresoj ta gëzoni për jetë e mot.

Erta Muçkurtaj Kl.VIII

SHQIPONJA E ARRATISUR

Një liqen po kalon
Një derë po hapet
Një degë po kërcet,

Shqiponja e arratisur
për ndihmë po thërret.
Një njeri po gropon

Po gropa po mbulohet,
Një njëri po shpreson
Po shpresa po largohet.

Po pastaj shterohet,
Dikush po lufton po
Pastaj harrohet.

KËSHTU E DUA VENDIN TIM

Vendin tim unë shumë e dua,
Për të do e flijoja veten ,
nuk do mendoja për asgjë tjetër.

Shumë luftëtarë sakrifkuan për liri.
Që ne sot të kemi pavarësi.
17 Shkurti , kjo ditë kombëtare.

Të gjithë shqiptarët janë ngritur në këmbë .
Kanë stolisur Kosovën në çdo anë e kënd .
Flamujt valëviten ,njerëzit festojnë ,
këtë ditë madhështore të gjithë e kremtojnë.

Erta Muçkurtaj Kl.VIII




Kaltrina Mema

NËNA

Kjo fjalë më e ëmbël se mjalta
Dashurinë ndaj teje s'e përshkruan as fjala
Ti je engjëll në tokë
Njeriu më i dashur në botë

Si një rreze dielli jetën ma ndriçon
Çdo këshillë e jotja mua më ndihmon
Je e mira që s'ka fund
Nëna ime të dua shumë.

Erta Muçkurtaj Kl.VIII



Gerta Ahma

DALLËNDYSHJA

Sot mbi shtëpi po fluturon
qiellin po e zbukuron
çdo vit kështu më tregon
qe pranvera po afron .

Folenë tënde të vjetër
çdo ditë e shikoj
zërin tënd të ëmbël
çdo ditë e kujtoj.

Sa herë ti largohesh
qytetit i ikën bukuria
kur ti je këtu
i shtohet madhështia.

Vesa Selmanaj VII-2

GJENIU I VOGËL

Gjeniu i vogël
është aq i zgjuar
sa arritjet e tij
janë për tu uruar.

Pë r menqurinë e tij
një libër nuk mbaron
zgjuarësia e tij
të ardhmen e ndihmon.

Truri i tij i vogël
përmban shumë detyra
zgjuarsinë e tij
e krijoj natyra.

Vesa Selmanaj VII-2

KLASA JONË

Klasa jonë
shtëpia e dytë
nga dija jonë
gati u përmyt.

Klasën tonë
kurrë nuk e harroj
sa gjëra këtu mësova
unë do ti kujtoj.

Kur të vij klasa e nëntë
me të do të përshëndetem
por gjithmonë me të
shok do të mbetem.

Vesa Selmanaj VII-2

MUZIKA

Muzika është art
kur të gjithë përfshihen
duke ecur e folur
tingujt arrihen.

Muzika është ëndërr
çdokush mund ta shikoj
si të gjitha të tjerat
mund ta realizoj.

Vesa Selmanaj VII-2

MAGJIA E FJALËS

Në brendësi të fjalëve
gjendet një magji
nganjëherë me hidhërim
e shpesh me dashuri.

Fjalët magjike
burojnë nga zemra
nuk mund ti caktojmë
sepse ka shumë emra.

Vesa Selmanaj VII-2

BISEDA E PEMËVE

Pemët mes vete
po bisedojnë
me erëra të ndryshme
fjalët i reflektojnë.

Pemët mes vete
bisedojnë përmes erës
e puhia e tyre
ndihet më shumë verës.

Shusherima e degëve
është zhurmë qetësie
për veshët tanë
tingull ëmbëlsie.

Vesa Selmanaj VII-2



Adna Sadiku

DUA TË UDHËTOJ

Dua të udhëtoj
botën ta shikoj
çdo moment ta përjetoj
kurrë mos ta harroj.

Dua të udhëtoj
ëndrrën ta realizoj
të gjitha bukuritë e botës
çdo ditë t'i vizitoj.

Në një ditë të bukur
së bashkun me diellin
do të doja të udhëtoj
ta shikoj të gjithë qiellin.

Vesa Selmanaj VII-2

YLBERI

Sa herë e shoh ylberin
mbushem me dashuri
si spketër ngjyrash
na afron shumë bukuri.

Këtë bukuri të rrallë
na e krijoj natyra
në mënyrën më të mirë
i harmonizoi këto ngjyra.

Kur shfaqet ylberi
zbukurohet qielli
nga bukuria e tij
shkëlqen edhe Dielli.

Vesa Selmanaj VII-2

DETI

Një ditë dallgët
po bënëin shumë zhurmë
mbi to pulëbardhat
fluturonin në turmë.

Zhurma e dallgëve
kur përqafoheshin mes veti
më bëri të kuptoj
sa qetësues qenka deti.

Uji i kristaltë
më bëri të kujtoj
që freskinë e ujit
s'duhet ta harroj.

Vesa Selmanaj VII-2



Erza Ulnika

SHKOI VERA ERDHI VJESHTA

U zhduk vapa
shkoi vera
në vend të tyre
erdhi shiu e era.

Zhurma e shiut
si këngë melodike
gjethet e pemëve
ndryshojnë e bien.

Ngjyrat e ngrohta
të kësaj stine
na e mbushen shpirtin
plot me gëzime.

Vesa Selmanaj VII-2

GJUHA SHQIPE

E qiltër si qielli
e bukur si dielli
si era e veriut

Është gjuha shqipe,
gjuha e njeriut
kurrë ajo nuk harrohet
dita-ditës po përparohet.

Teuta Markaj VII-3

ATDHEU

Si një lule që s'vshket kurrë
si një ujëvarë që s'shuhet fare
si një këngë në abetare.

Si një yll në galaktikë
që natës i jep dritë,
është atdheu im

që më mbush me krenari
kudo që dëgjohet emri
Kosovë e Shqipëri.

Teuta Markaj VII-3

MËSUESJA IME

Me çantë në kraharor
e me ditarë në dorë
Mësuesja jonë e parë
po hynë në klasën tonë.

Ne e përqaftuam
mësuesen tonë të dashur
të cilën edhe sot
e kujtoj me mallë.

Teuta Markaj VII-3

GJYSHJA IME

Gjyshja më tregon
përralla të bukura
gjyshja më tregon

respektin e mirësinë
gjyshja më mëson
dashurinë e trimërinë.

Teuta Markaj VII-3

FAMILJA IME

E nisur nga gjyshërit
e deri tek unë
kjo është familja ime
që e dua shumë.

Gjyshi e gjyshja
babi, mami vëllai e unë
ne të gjithë së bashku,
jemi familje e madhe shumë.

Familja ime e dashur
shumë të respektoj
sepse për mua jeni
çdo gjë që dua unë.

Teuta Markaj VII-3

PRANVERA

Plot me lule ngjyra-ngjyra
u mbushen kodra e lugina
Zogjtë andaj po fluturojnë
qerdhet e tyre po ndertojnë.

Zogjët shtegtarë tani kanë ardhë
foletë e tyre për t'i parë
thonë fëmijët plot hare
mirë se erdhe pranverë tek ne.

Teuta Markaj VII-3



Erta Muçkurta

LIBRI

Librin unë e dua
e kam më të mirin mik
pa të jam e zbrazët
nuk kam aspak dritë.

Ajo më ndihmon
që unë të përparoj
si të ardhmen time
unë ta ndërtoj.

Teuta Markaj VII-3

DUA

Dua të jem e lirë
e qiellin ta admiroj
dua të jem e lirë
si zog të flututoj.

Dua që luleve
aromën t'ua shijoj
si bleta e lehtë
mbi to të qëndroj.

Teuta Markaj VII-3

PËR ÇFARË

Për çfarë u mundove
të më shkatërroje
Përse u mundove
atdheun të ma pushtojë.

Për çfarë u përpoqe
gjuhën të ma zhdukje,
për çfarë u mundove
lirinë të ma humbje.

Teuta Markaj VII-3

LIRIA

O vendi im gëzohu
se na erdhi liria
që me vjet e pritëm
të festohet liria.

Tan jemi të lirë
të shkojmë në shkollë
të lozim e këndojmë
e kurrë të mos pushojmë.

Teuta Markaj VII-3

LIRIA

Fjalë e ëmbël fjala liri
është e mbushur me lumturi
fjalë e bukur fjalë bujare
faleminderit ushtrisë çlirimtare.

Sa shumë gjak është derdhur
sa shpirti është shuar
lirinë tonë të shtrenjtë
me sakrificë e kemi fituar.

Fjalën liri
do e kujtojmë gjithmonë
që atdheu im
të mbetet në zemrën tonë.

Jemi të gëzuar
që jetojmë në liri
me 17 shkurt
e kurorëzuam me pavarësi.

Vesa Selmanaj VII-2

LIBRI, BURIM I DITURISË

Je vatër e diturisë
pasuri e shtëpisë
ëndërr e ardhmerisë
yll i lirisë.
Secili libër
është kapitull i ri
që do t'i lexoj
me shumë dashuri.
Je urë për tu kaluar
që shumë duhet mësuar
rrugën ma ndriqon
gjëra të vlefshme më mëson.
Sa shumë gjëra
nga ti mësova
trurin tim
ma dije e pasurova.
Unë shumë nga ti
kam mësuar
ditë e natë nuk mjafton
për t'u falenderuar.

Vesa Selmanaj VII-2

MËSUES

E ëmbël është kjo fjala mësues
prej dijes së tyre ka shumë pasues.

Kur vjen 7 marsi unë gëzohem shumë
falenderimet për ta më rrjedhin si lum.

Sakrificat e tyre për rrugëtim të vërtetë
do më mbetet në mend për mot e për jetë.

Mësues, mësues shumë falemiderit
nuk do të zhgënjej ta jap fjalën e nderit.

Vesa Selmanaj VII-2

SHKOLLA IME

Shkolla ime
vatër e diturisë
e çmuar për çdokënd
lule e ardhmërisë.

Shtëpia ime tjetër
dhe një kujtim të vjetër,
qelës i çdo suksezi
që përcillet brez pas brezi.

Shumë gjëra nga ti mësova
trurin tim e pasurova
mësova si të jetoj
vlerën tënde s'do e harroj.

Vesa Selmanaj VII-2

LUMBARDHI

Bukuri e qytetit tim
gjallëri e shpirtit tim
zemrën ma qetëson
paqe më krijon.

Zhurma jote gurgulluese
për çdo njeri është ëndërruese
kur ty unë të shikoj
gjëra të mira mendoj.

Po të mos ishe ti
Peja s'do kishte shumë bukuri
e veçanta e vendit tim
më ngjall mua ngazëllim.

Vesa Selmanaj VII-2

17 SHKURTI

Pas shumë pushtimesh mbijetove
popullin tënd kurrë se harrove
Kosovë e dashur, Kosovë e bukur
je atdheu im që më bën të lumtur.

Emri yt sot po ndrit
çdokush sot flamurin po e ngrit
je e fortë e luftëtare
dhe në fund dole fitimtare.

Sot të gjithë po vallëzojnë
me gjithë shpirtin po festojnë
janë mbledhur këtu për të festuar
lirinë tonë s'duhet harruar.

Vesa Selmanaj VII-2

ÇKA DUA...

Do të doja të isha yll
në qiell të qëndroja
e rrugën e errët
të tjerëve t'ua ndriqoja.

Do të doja të kisha aftësinë
njerëzit t'i shëroj
qe secili në botë
pa sëmundje të rrojë.

Do të doja të isha libër
të tjerët t'më lexonin
e nga dituria ime
nga pak të mësonin.

Nganjëherë e pyes veten
Çka do në jetë?
përgjigjena që e marr
'„Lumturi të vërtetë'>

Vesa Selmanaj VII-2

NËNË

Nënë , o nënë
emër i bekuar
nga shpirti yt
një pjesë ma ke dhuruar.

Më solle në jetë
me shumë mundime
tash të them
shumë falënderime.

Nënë e dashur
më je fytyrëndrituar
të të shoh për herë të parë
shumë kam pritur.

Sa herë më buzëqesh
më gëzohet fytyra
më mbush botën time
me shumë, shumë ngjyra.

Vesa Selmanaj VII-2

SKENDËRBEU

Për atdhe ti luftove
Shqipërinë kurrë se tradhtove
ne jemi krenarë
se ti ishe shqiptar.

Heroizmi yt s'ka kufi
mburremi me trimërinë tënde
O trimi ynë legjendar
S'do harrohet shekuj me radhë.

Kur vdiqe ti o Skendërbe
dielli nuk ndriqoi më
këmbanat nuk kumbuan
zemrat vajtuan.

Vesa Selmanaj VII-2

SHOQJA IME

Shoqja ime
besnike e vërtetë
që nuk më braktisi
asnjëherë në jetë.

Sekretet e mia
asaj ia tregoj
sepse vetëm asaj
për këtë i besoj.

Vesa Selmanaj VII-2

LIBRI IM

Libri im i dashur
Sa shumë që të dua
Diturinë që kam
Ti ma jep mua.

Përrallat e tua
Gjithmonë pres t'i dëgjoj
Libri im i dashur
Me ëndje të lexojë.

Eljesa Hasanaj kl.VI

LIBRI,BURIM I DITURISË

Nga libri njeriu mëson
Libri të ardhmen tënde e tregon.
Për çdo njeri libri është I veçantë

Pa libër njeriu nuk është elegantë.
Shoku më i mirë
Gjithmonë do të jetë.

Ne ndonjëherë gabojmë
Por dhe gabimet i tejkalojmë
Kurrë nuk është vonë
Që ne të mësojmë.

Riad Gashi kl.VI

PRANVERA

Po vjen dallëndyshja
Sikur vitet e tjera
Na bjen lajm të mire
Thotë erdhi pranvera

Erdhi lejleku
Në folen e vet
Çdo fëmijë i mirë
Krah hapur na pret.

Me gjelbërim
U mbush natyra
Çdo fëmijë
I qesh fytyra.

Eljesa Hasanaj kl VI

POEZIA


Me poezi do të rroj
Poezinë me asgjë tjetër nuk ndërroj
Poezia është jeta ime
Dhe unë atë e adhuroj.

Poezia rrjedh nga shpirti
Dhe jo nga goja e mendja
Një autor i vërtetë
Veç atë e dëshiron në jetë.

Tefik Agusholli



Enxhi Sefaj



Gerta Ahma



Leona Bacoviq



Kaltrina Mema



Blerta Gjickolli



Elea Krasniqi



Erta Muçkurtaj



Flandër Kuçi
Amina Zhara, Blend Lajqi



Adna Sadiku



Melos Mahmuti



Elsa Çavderbasha



Gerta Ahma



Erza Ulnika



Asiye Hajrizaj



Adna Sadiku




Adna Sadiku



Adna Sadiku



Vesa Selmanaj



Elsa Çavderbasha



GJON CULAJ

Lindi në vitin 2004 në qytetin e Pejës, në një familje prej shtatë antarësh. Vijon mësimin në SHMU "Asdreni" në Pejë. Jeta e tij jo çdo herë ishte e lehtë, por asnjë ngjarje ,sado tronditëse nuk mjaftoi që ta largonin nga rruga e tij, sepse dashuria për poezi nuk e lejonte. Talenti tij u dallua që nga mosha 11 vjeçare saktësisht në klasën e gjashtë, ku frymzimi i tij kryesor u bë humbja e një njeriu të dashur , një njeriu të zemrës që pati. Shpeshherë atë e pyesin se çka e frymëzon, por ai përgjigjet: " se këto ishin fjalët e zemrës" që s'mund t'i thoshte por t'i shkruante. Po në çdo varg shkruesi lë dhe përcjell një emocion ngase I shkruan me ndjenja. Pëlqen të shkruaj vjersha të shumta dhe të ndryshme përnga temat si: patriotike, të dashurisë ,shoqërisë, dhembshurisë etj. Gjëja që në shpirtin e tij zgjon jehonë të madhe është tezja e tij, loti I nënës, malli për të, dashuria, shiu, i panjohuri, libri, ushtari etj.



Unë jam **ELJESA HASANAJ**.

Kam lindur në Pejë, më 03.12.2007.

Jam nxënëse e Kl. VI/2, në S.H.M.U.

„Asdreni" në Pejë. Mua më pelqejnë

poezitë, dhe kam filluar t'i shkruaj që

nga klasa e tretë. Përveç poezive, më

pëlqen edhe të lexoj libra të

ndryshme.



Unë jam **RIAD GASHI**.

Kam lindur në Pejë, më 26.09.2007.

Vijoj mësimet në S.H.M.U.

„Asdreni", në Pejë. Jam në klasën

VI/2. Mua të gjitha lëndët më

pëlqejnë, por më shumë e dua Gjuhën

Shqipe, dhe gjuhët e huaja. Më

pëlqen të shkruaj poezi, dhe

frymëzimin e marr nga Nëna dhe

Motra ime, të cilat më përkrahin për

çdo gjë.



Unë jam ***FLANDER KUQI***.

Kam lindur në vitin

2005.Vendlindja ime është Peja.Aty

i vijoj mësimet në shkollën

Asdreni,dhe jam në klasën e VIII-1.

Unë kam shkruar dhe vazhdoj të

shkruaj poezi të ndryshme,me tema

të ndryshme si për

atdheun,shkollën,librat,natyrën etj.



Unë quhem ***ERTA MUÇKURTAJ***.

Kam lindur më 04.06.2005 në Pejë.

Vijoj mësimet në shkollën „ASDRENI” në klasën

e tetë.Hobi im është të shkruaj poezi.



Qnhem **BLERTA GJIKOLLI**.

Kam lindur në Pejë. Jam nxënëse e shkollës SH.M.U “Asdreni” , në klasën VIII-4 me sukses të shkëlqyer . Jam 14 vjeç.Talenti im në letërsi është zbuluar që kur isha e vogël. Në orët e lëndës së gjuhës shqipe ndjehem shumë mirë. Kur arsimtarja na jap detyra që të shkruajmë poezi ose ese atëherë unë ato i shkruaj me kënaqësi dhe i thurri fjalët mjaftë mirë.

Më pëlqen të lexoj romane por dhe të shkruaj

tregime. Unë mendoj se në të ardhmën do të bëhem një shkruese shumë e mirë ,por nuk qëndroj keq edhe me shkruarjen e poezive. Më pëlqen të shkruaj për ngjarjet nga jeta e përditshme si për: dashurinë, atdheun, festat kombëtare si dhe shkrime me mesazhe për një jetë më të mirë. Librat që më pëlqejnë më së shumti janë nga autorët botërorë si: J.K Rowling, Hana Ozhogovska , Honore De Balzak por edhe nga autorët tanë shqiptarë si: Haki Stërmilli, Nazmi Rrahmani, Naim Frashëri etj.



TEFIK AGUSHOLLI

Lindi me 24.05.2007. Jeton dhe vepron ne Pejë.Poezin e parë e shkroi në moshën 7 vjeçare.Ai mëson në shkollën" Asdreni" në Pejë. Si një nxënës I shkëlqyeshëm që është,frymëzimi tij vjen pothuajse nga çdo gjë që sheh, por kryesisht e kaplon dashuria për atdheun, sepse çdo gjë mund të ndërrohet përveç se vendlindja.Libri është shoku I pandashëm i tij.



Unë quhem **TEUTA MARKAJ**.
Kam lindur me 11.7.2006. Jam në klasën VII/3 në shkollën "Asdreni" në Pejë. Më pëlqen të shkruaj dhe ëndrra ime është të jem shkrimtare sepse kur shkruaj mbushem me frymëzim. Unë kam shkruar shumë tregime dhe poezi të cilat do t'i botoj me titullin "Bota ime". Mua më pëlqen edhe të lexoj dhe tani kam lexuar romane të ndryshme si "Malësorja", "Përtej largësive".



Unë jam **VESA SELMANAJ**.
Jam dymbëdhjet vjeç. Kam lindur me 29.9.2006 në Pejë. Jetoj në Pejë. Vijoje mësimet në shkollën "Asdreni" në Pejë. Talentin tim për shkrim e kam trashëguar nga familja ime. Çdo ditë kam dëshirë të shkruaj poezi dhe tregime poashtu të kem një frymëzim të ri. Talentim tim e kam zhvilluar që nga klasa e parë ku frymëzohesha në çdo gjë që më vinte rrethonte. Çdo gjë që ndodh në botë dhe që e përshkon atë është frymëzim për mua. Kam dëshirë të imagjinoj, sepse mendoj se imagjinata është çelësi i suksesit të çdo shkrimtari.

1. Ushitari
2. Shqipëri- o nëna ime
3. Shqipëtarët
4. Shqiponja e arratisur
5. Shqipëri etnike
6. Përse
7. Për ju o dëshmor...
8. Një ditë hyjnore
9. Ne na bashkon
10. Moj Shqipëri
14. Mërgimtarë
15. Malli për ty
16. Loti I nënës
17. Libri
18. Kosova ime e dashur
19. Ju lutem
20. Jeta
21. I panjohuri
22. Gjuha shqipe
23. Gjuha jonë
24. Emri shqipëtar
25. Dita legjendare
26. Dëshmorët vdesin, fëmijët jetima mbesin
27. Dashuria
28. Bejtexhinjtë

29. Bajram Curri
30. Asdreni
31. A po a jo
32. 28 Nëntori
33. Kuq e zi
34. I varfëri dhe I pasuri
35. Ëndrra ime
36. Libri, burim I ditorisë
37. Pranvera
38. E dua këtë ditë hyjnore
39. Atëherë
40. 28 Nëntori
41. Shqiponja e arratisur
42. Kështu e dua vendin tim
43. Nëna
44. Dallëndyshja
45. Gjeniu I vogël
46. Klasa jonë
47. Muzika
48. Magjia e fjalës
49. Biseda e pemëve
50. Dua të udhëtoj
51. Ylberi
52. Deti
53. Shkoi vera erdhi vjeshta

54. Gjuha shqipe
55. Atdheu
56. Mësuesja ime
57. Gjyshja ime
58. Familja ime
59. Pranvera
60. Libri
61. Dua
62. Për çfarë
63. Liria
64. Liria
65. Libri burim I diturisë
66. Mësues
67. Shkolla ime
68. Lumbardhi
69. 17 Shkurti
70. Çkadua
71. Nënë
72. Skendërbeu
73. Shoqja ime
74. Libri im
75. Libri, burim I diturisë
76. Pranvera
77. Poezia

LEKTOR:

Pranvera Berisha
Merita Hajdari
Merita Gashi Muriqi
Sevdije Rexhaj

KOPERTINA:

Adna Sadiku

Falënderim i veçantë për kontribut dhe bashkëpunim të dhënë për realizimin e Librit **“Përmbledhje poezish”** nga nxënësit e shkollës dhe mësimdhënësit e Gjuhës Shqipe, dhe Artit Figurativ të cilit e pasuruan lektyrën me punimet e tyre artistike në përkrahjen e mësimdhënësit Lulzim Goqi.

Veçanërisht e falendërojmë drejtoreshën e Shkollës “Asdreni”, Agime Lajçi për përkrahjen dhe krijimin e mundësisë për realizimin e këtij libri, duke motivuar krijuësit e rinjë brenda shkollës.

